



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1005/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.P “Termokos” SH.A, me seli rr.”28 Nëntori’ nr.181 Lagja “Dardania” Prishtinë, ndaj debitorit “Nidesk Projekt” Kaltrina Veseli, me seli ne rr. “Ulpiana” D-1 H2 nr.02 ne Prishtinë, përfaqësuar nga Zyra e Avokateve “...” shpk, ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë KPPP nr.1294/22 dt.25.05.2023, me datën 10.11.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit N.P “Termokos” SH.A, me seli rr.”28 Nëntori” nr.181 Lagja “Dardania” Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë KPPP nr.1294/22 dt.25.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP nr.1294/22 dt.25.05.2023, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit “Nidesk Projekt” Kaltrina Veseli, me seli ne rr. “Ulpiana” D-1 H2 nr.02 ne Prishtinë dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.1778/21 dt.09.12.2021 te Përmbaruesit Privat Valdrin Beka si dhe ka përfunduar ne tërësi përmbarimin ne këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te shkeljes se dispozitave ligjore, vlerësimit te gabuar te gjendjes faktike dhe te drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej ne shkalle te parë ne rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkalles se Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P “Termokos” SH.A, me seli rr.”28 Nëntori’ nr.181 Lagja “Dardania” Prishtinë, me datën 08.12.2021, ka paraqitur propozim për përmba rim ndaj debitorit “Nidesk Projekt” Kaltrina Veseli, me seli ne rr. “Ulpiana” D-1 H2 nr.02 ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Kartelës se Kontabilitetit me shifër nr.61004. Përmba ruesi Privat Valdrin Beka nga Prishtina, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmba rimor P.nr.1778/21 dt.09.12.2021, ka lejuar përmba rimin, me të cilin detyrohet debitori që kreditorit në emër te detyrimit sipas kartelës, t’ia paguaj shumën prej 1,101.87 euro, me kamatën prej 8% ne vit llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmba rimore.

Kundër urdhrin përmba rimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 16.12.2021, me pretendimin se faturat te cilat janë evidentuar ne kuadër te kartelës janë nga data 25.10.2016 ndërsa urdhri përmba rimore është lëshuar për ekzekutim me datën 09.12.2021, apo 5 vite e 44 ditë me vonë ashtu qe debitori konsideron se për këto fatura ka arritur afati i parashkrimit. Debitori i referohet nenit 360 te LMD për parashkrimin e afatit andaj konsideron se detyrimet e debitorit ndaj kreditorit janë parashkruar propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmba rimor ta shfuqizoj .

Përgjigje ndaj prapësimit te debitorit ka ushtruar kreditori me datën 20.12.2021, me pretendimin se prapësimi i debitorit është ushtruar ne kundërshtim me dispozitat e LMD, është e qartë dhe precizuar ne LMD se çdo shërbim i ofruar duhet te paguhet dhe ne rastin konkret obligimi-detyrimi dhe e drejta krijojnë raport kreditor-debitor. Kreditori pretendon se nuk qëndron pretendimi i debitorit se borxhi ndaj tij është parashkruar sepse ne këtë rast nuk kemi te bëjmë me nenin 360 te LMD pasi institucionet e biznesit afatin e parashkrimit e kanë 3 deri ne 5 vite bazuar ne nenin 352 dhe 353 te LMD, qëllimi i vetëm i debitorit është prolongimi i procedurës, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe borxhi i debitorit ndaj kreditorit te ekzekutohet.

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.129422 dt.25.05.2023, me të cilin e ka provuar si te bazuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmba rimor ndërsa ka përfunduar ne tërësi procedurën përmba rimore ne këtë çështje duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit gjykata i referohet nenit 29 par.3 si dhe nenit 37 te LPP. Gjykata gjeti se dokumenti Kartela e Kontabilitetit me nr.61004 ne bazë te cilës është lejuar përmba rimi nuk i plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm nga neni 29 par.1 nenpar.1.2 te LPP dhe me këtë dispozitë nuk është përcaktuar si dokument i besueshëm. Duke marrë parasysh faktin se ne rastin konkret propozimi për përmba rim është lejuar sipas dokumentit –kartelës se kontabilitetit, gjykata vlerëson se dokumenti mbi te cilin mbështetet propozimi për përmba rim nuk konsiderohet dokument i besueshëm dhe si rrjedhojë e kësaj urdhri i lejuar nga përmba ruesi privat duhet te anulohet dhe procedura përmba rimore te përfundohet ne tërësi.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkalles se Dytë, vlerëson se propozimi për përmbarrim është lejuar në bazë të dokumentit të kreditorit - Kartela e Kontabilitetit me shifër nr.61004, i cili dokument sipas nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139, nuk është dokument i besueshëm sepse një dokument i tillë mbi bazën e të cilit kreditori ka iniciuar procedurën përmbarrimore dhe Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin, me dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm.

Neni 29 par.1 nenpar.1.2 parasheh si dokumente të besueshme “*Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, gjë që dokumenti i kreditorit N.P “Termokos” SH.A - Kartela e Kontabilitetit me shifër nr.61004, nuk është i paraparë si dokument i besueshëm me këtë dispozitë ligjore sepse në rastin në fjalë kemi të bëjmë me shërbime të ngrohjes të ofruara nga kreditori. Prandaj, gjykata e shkalles se dytë i analizoi pretendimet e kreditorit por që të njëjtat i vlerësoi si jo relevante për një vendosje ndryshe, ashtu që këto pretendime mbesin vetëm të natyrës deklarative dhe jo konform nenit 69 par.4 të LPP, ashtu që i refuzoj si të pabazuara dhe aktvendimin e gjykatës se shkalles se parë e vërtetoj, ndërsa për realizimin e pretendimeve ankimore të kreditorit kjo gjykatë udhëzon kreditorin në procedura tjera siç është ajo kontestimore.

Përndryshe, në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1005/23, me datë 10.11.2023

Gjyqtari,
Dren Rogova